



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

FONDI PËR TË DREJTËN HUMANITARE KOSOVË

BULETINI PËR DREJTËSI TRANZICIONALE



SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

ÇKA ËSHTË DREJTËSIA TRANZICIONALE?

Drejtesia Tranzicionale përfshinë tërësinë e proceseve dhe mekanizmave që lidhen me përpjekjet e një shoqërie për tu përballur me një trashëgimi të abuzimeve në shkallë të gjerë në të kaluarën, për të siguruar llogaridhënien, drejtësinë dhe pajtimin.¹ Këto procese mund të përfshijnë mekanizma gjyqësor dhe jo gjyqësor, me apo pa përfshirje ndërkombëtare dhe karakterizohen me ndjekje penale individuale, reparacione, gjetjen e së vërtetës, reforma institucionale, procese të vetingut/verifikimit dhe shkarkime apo një kombinim i të njëjtave.²

Drejtesia Tranzicionale shërben si një kundër-përgjigje ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur në të kaluarën, qoftë gjatë periudhave kur shoqëritë përballeshin me konflikte të armatosura apo kur përballeshin me sisteme qeverisëse autoritare.

Konfliktet e armatosura dhe sistemet autoritare karakterizohen me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, si vrasje, zhdukje më dhunë, tortura, përfshirje përdhunime, arrestime, shpërngulje të dhunshme, etj. Andaj nevojitet një përgjigje e institucionalizuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj këtyre shkeljeve.

Një periudhë të tillë e ka kaluar edhe Kosova gjatë viteve të 90-ta e sidomos gjatë periudhës 1998-1999 kur ndodhi konflikti i armatosur në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në njërin anë dhe Forcave Ushtarake të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe forcave policore të Serbisë në anën tjetër.³ Gjithashtu shkelje të të drejtave të njeriut ndodhën edhe menjëherë pas përfundimit të luftës.

Që nga qershori i vitit 1999, me përfundimin e luftës, Kosova ka hyrë në një epokë të një tranzicioni të dyfishtë. Në njërin anë shteti i Kosovës është duke u përballur me një të kaluar të hidhur të krimeve si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999 dhe

¹Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm për Sundim të Ligjit dhe Drejtësi Tranzicionale në shoqëritë në konflikt dhe pas konfliktit, (2004), Dok. i OKB-së, S/2004/616, para. 8

²Po aty

³Përgjegjësia ushtarake ka qenë e ndarë në këtë mënyrë:

Forcat Ushtarake që kanë vepruar në Kosovë gjatë luftës, kanë qenë pjesë e Ushtrisë së Jugosllavisë (Republika Federative Jugosllave në këtë kohë përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi); Forcat policore kanë qenë nën komandën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë; Ndërsa Forcat Paramilitare kanë qenë grupe të organizuara të armatosura të cilat janë mbështetur në mënyrë logjistike dhe gjithashtu janë komanduar nga Ushtria e Jugosllavisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë.

në këtë mënyrë është duke punuar në sigurimin e një paqeje të qëndrueshme pas konfliktit. Ndërsa në anën tjetër marrë parasysh që gjatë periudhës kur Kosova ishte krahinë autonome e ish-RSFJ karakterizohej me një sistem komunist qeverisës, tani Kosova është duke kaluar në një proces tjetër tranzitor, atij të shtet-ndërtimit bazuar në vlerat demokratike.

Duke konsideruar rolin kyç të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale në ballafaqimin me të kaluarën me qëllim ndërtimin e një paqeje të qëndrueshme pas konflikteve të armatosura dhe demokratizimin e shteteve autoritare, është e rëndësishme që institucionet e Kosovës dhe shoqëria kosovare në përgjithësi të angazhohet në zbatimin e tyre.

Por para se të flasim se si zbatimi i mekanizmave të drejtësisë tranzicionale kontribuon në paqe dhe demokratizim, fillimisht duhet ta njohim të kaluarën.

SI KA ARDHUR DERI TEK LUFTA NË KOSOVË?

SHPËRBËRJA E JUGOSLLAVISË

Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, (RSFJ), si shtet federal është formuar më 29 nëntor të vitit 1945. RSFJ përbëhej nga gjashtë republika: Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Sllovenia si dhe nga dy krahina: Kosova dhe Vojvodina.

Pas vdekjes së presidentit të RSFJ-së Josip Broz Tito më 4 maj 1980 dhe pas rënies së komunizmit disa vite më vonë, filloi epoka e përplasjeve mes etnive që përbënin këtë shtet federal.

Si pasojë e rivaliteteve mes republikave dhe krizës ekonomike, RSFJ filloi të shpërbëhet, ku Sllovenia ishte republika e parë e cila u shkëput dhe e shpalli pavarësinë më 25 qershor 1991. Në Slloveni është zhvilluar lufta e ashtuquajtur dhjetëditëshe prej datës 27 qershor deri në datën 7 korrik të vitit 1991, gjatë së cilës janë vrarë 65 persona dhe rreth 320 të tjerë janë plagosur. Sikurse Sllovenia, ashtu dhe Kroacia, e ka shpallur pavarësinë në datën 25 qershor të vitit 1991.

Por për dallim nga Sllovenia, lufta në Kroaci veçse kishte filluar në muajin mars të vitit 1991 dhe zgjati deri në muajin nëntor të vitit 1995. Sipas disa të dhënave të pakonfirmuara, gjatë kësaj lufte janë vrarë dhe/apo janë zhdukur deri në 22.000 persona.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë lufta ka filluar një vit më vonë se ajo e Kroacisë, pra në muajin prill të vitit 1992 dhe ka përfunduar në muajin nëntor të vitit 1995, një muaj pas përfundimit të luftës në Kroaci. Gjatë luftës në Bosnjë, mbi 95.000 persona janë vrarë dhe/apo janë zhdukur.



LUFTA NË KOSOVË

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Kosova mbeti pjesë e Serbisë në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Që nga ajo kohë, Kosova bëri përpjekje të vazhdueshme për të drejta kombëtare, kulturore, arsimore, për t'u kthyer në Republikë si pjesë e shtetit federativ si dhe në vitet 90-ta për pavarësi të plotë. Situata e paqëndrueshme u rrit gjatë demonstratave të vitit 1968. Aso kohe pati një mobilizim të popullsisë shqiptare në Kosovë dhe thirrja kyçe e demonstratave ishte kërkesa për pozitë më të lartë kombëtare, identitet dhe respekt të shqiptarëve në kuadër të kushteve të rishikimit të sistemit federativ. U bënë thirrje që të siguroheshin të drejtat kombëtare, si e drejta për përdorimin e barabartë të gjuhës shqipe, e drejta për përdorimin e flamurit kombëtar si dhe u shtrua kërkesa për universitet në gjuhën shqipe. Si rezultat i këtij presioni, Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974 i dha Kosovës dhe Vojvodinës statusin e Krahinave Socialiste Autonome në kuadër të Serbisë. Si e tillë, Kosova zotëronte të drejtat pothuajse të barabarta si edhe gjashtë republikat përbërëse socialiste të RSFJ-së. Përmes Kushtetutës të vitit 1974, Kosova u njoh si element konstituiv i RSFJ-së.

Në fillim të vitit 1981 filluan demonstratat e studentëve me kërkesën themelore "Kosova Republikë", për tu shndërruar më vonë në protesta mbarë popullore për pavarësi të plotë nga ish-Jugosllavia. Këto demonstrata u shtypen me dhunë.

Më 23 mars 1989, Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nën masa të dhunshme miratoi projektin e ndryshimeve kushtetuese⁴ në Kushtetutën e Kosovës, i cili projekt më 28 mars 1989 u miratua edhe në Kuvendin e Serbisë dhe efektivisht hoqi autonominë e Kosovës. Për të shprehur pakënaqësitë e tyre shqiptarët organizuan demonstrata masive kundër politikës së Millosheviqit, gjithashtu filloi greva e urisë së 1300 minatorëve të Trepçës. Më 2 korrik 1990, deputetët e Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nxorën Deklaratën Kushtetuese duke e shpallur Kosovën njësi të pavarur dhe të barabartë në kuadër të RSFJ-së. Në shtator të vitit 1991, u zhvillua referendum i mbarë popullor që zyrtarisht e shpalli Kosovën të pavarur e sovranë, ndërsa Ibrahim Rugova u zgjodh njëzëri Kryetar i Republikës në zgjedhjet e vitit pasues dhe organizoi rezistencën paqësore kundër masave të dhunshme serbe.

⁴Ky amendamentim përfshinte propozimet e Kuvendit të Republikës së Serbisë drejtuar dy Krahinave Autonome të saj, Kosovës dhe Vojvodinës. Kërkesa bazë e këtyre propozimeve përfshinte suprimimin e autonomisë së dy këtyre krahinave autonome dhe vendosjen e tyre nën udhëheqjen e tërësishme të Republikës së Serbisë. Dhe ky projekt ishte një nga hapat e parë që ndërmori Slobodan Milosheviq menjëherë pas ardhjes së tij në pushtet në vitin 1989.

Por në pamundësi për të ushtruar pushtet efektiv dhe e përndjekur nga forcat serbe, qeveria e Kosovës u tërhoq duke dështuar të jap rezultate. Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë gjatë viteve të 90-ta mbeti jashtëzakonisht e vështirë. Pothuajse të gjithë të punësuarit në sektorin publik u dëbuan nga puna, u mbyll universiteti i Prishtinës dhe shkollat e mesme në gjuhën shqipe. Po ashtu u ndalua shtypi dhe radiotelevizioni në gjuhën shqipe. Për t'u përballur me këtë sfidë, shqiptarët e Kosovës organizuan një sistem paralel duke ofruar shtëpitë e tyre për të zhvilluar arsimin në gjuhën shqipe dhe ndihmuan në hapjen e klinikave mjekësore. Ndërkohë, u burgosën dhe u keqtrajtuuan me mijëra shqiptarë dhe shumë prej tyre edhe humbën jetën, ndërsa me qindra e mijëra të tjerë u detyruan ta lëshojnë vendin dhe të kërkojnë azil në Evropën Perëndimore.

Pakënaqësia e popullsisë shqiptare në Kosovë u shpreh përmes protestave dhe demonstratave deri në fillimin e konfliktit të armatosur në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në njërën anë dhe Forcave Ushtarake të RFJ-së, Forcave Policore dhe Paramilitare serbe në anën tjetër.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) u themelua nga mesi i viteve të 90-ta si një forcë ushtarake e shqiptarëve të Kosovës. Në fillimet e aktiviteteve të saj, UÇK u karakterizua me sulme të fshehta të armatosura ndaj policisë serbe në Kosovë, ndërsa më 28 nëntor të vitit 1997 pjesëtarë të uniformuar të kësaj force ushtarake u shfaqën publikisht në fshatin Llaushë të Skënderajit ku edhe prezantuan qëllimet dhe arsyet e themelimit të kësaj organizate ushtarake. Ushtria Çlirimtare e Kosovës vazhdoi aktivitetin e saj ushtarak deri në qershor 1999 kur edhe iu nënshtrua procesit të çarmatimit, demobilizimit dhe transformimit dhe më 21 shtator të po atij viti u themeluan Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

Intensifikimi i konfliktit të armatosur dhe shkelja masive e të drejtave të njeriut ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, mori një vëmendje të gjerë ndërkombëtare. Dështimet e njëpasnjëshme të faktorit ndërkombëtar për një marrëveshje paqësore me presidentin e RFJ-së, Slobodan Milosheviq, lidhur me situatën në Kosovë, rezultuan në intervenimin ushtarak të Aleancës Veri-Atlantike (NATO) kundër çaqeve ushtarake të ushtrisë jugosllave në Kosovë dhe në territorin e RFJ-së. Intervenimi ushtarak i NATO-s në Kosovë filloi më 24 mars 1999 dhe zgjati për 78 ditë deri më 9 qershor 1999 kur edhe u arrit marrëveshja e Kumanovës e cila parashihte tërheqjen e forcave të RFJ-së dhe forcave serbe dhe hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë. Tërheqja e plotë e këtyre forcave zgjati deri me 20 qershor 1999.

Gjithashtu më 10 qershor 1999, në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara u votua Rezoluta 1244 e cila ofronte një zgjidhje të përkohshme për statusin e Kosovës në këtë periudhë.

Përmes Rezolutës 1244, territori i Kosovës u vendos nën administrimin ndërkombëtar përmes misionit të OKB-së, UNMIK⁵, ndërsa përgjegjës për sigurinë territoriale dhe të qytetarëve që jetonin në territorin e Kosovës u caktua KFOR (Forcat e Sigurisë së Aleancës Veri-Atlantike).⁶

Përderisa shqiptarët u kthyen në shtëpitë e tyre, me mijëra serbë dhe një numër i pjesëtarëve të pakicave tjera, ikën nga shtëpitë e tyre gjatë gjysmës së dytë të vitit 1999. Në këtë periudhë, u krijua një hapësirë për "hakmarrje" ndaj komuniteteve jo-shqiptare, veçanërisht ndaj komunitetit serb dhe romë.

Rindërtimi i Kosovës u ndihmua nga një mori organizatash ndërkombëtare. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) filloi punën për vendosjen e sundimit të ligjit dhe për themelimin e institucioneve vetëqeverisëse. Në vitin 2001, UNMIK-u miratoi Kornizën Kushtetuese të Kosovës dhe organizoi zgjedhjet e para të lira në historinë e Kosovës. Gjatë kësaj kohe, kompetencat kryesore në pushtetin ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor mbetën në duar të UNMIK-ut.

Kombet e Bashkuara, në ndërkohë, dërguan përfaqësues të tyre, Martti Ahtisaari-n, i cili në vitin 2007 nxori Planin Gjithëpërfshirës për Kosovën, ku parashihej pavarësi e mbikëqyruar me të drejta të zgjeruara për pakicat kombëtare, sidomos për serbët. Në bazë të këtij plani, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës më 17 shkurt 2008. Kushtetuta e Republikës u miratua më 9 prill 2008 dhe hyri në fuqi më 15 qershor 2008, kur edhe u bë transferimi i plotë i kompetencave prej UNMIK-ut në institucionet vendore. Në po të njëjtin vit, nën Rezolutën 1244, në Kosovë është instaluar një mision tjetër ndërkombëtar, Misioni Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX, mandati i të cilit është forcimi i sundimit të ligjit në Kosovë.

STATISTIKA MBI HUMBJET NË NJERËZ GJATË DHE PAS LUFTËS NË KOSOVË

Si datë zyrtare e fillimit të luftës në Kosovë njihet 28 shkurti i vitit 1998. Në fillim të vitit 1999, pas dështimit të negociatave për paqe (Rambuqe dhe Paris), Aleanca Veri-Atlantike - NATO dhe aleatët e saj, filluan më datën 24 mars të vitit 1999

⁵United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)


⁶Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit, S/RES/1244 (1999), e qasshme në: <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-t%C3%AB-bashkuara>

sulmet ajrore ndaj caqeve ushtarake jugosllave për 78 ditë me radhë. Lufta zgjati deri në datën 9 qershor të vitit 1999 dhe përfundoi me nënshkrimin e marrëveshjes së Kumanovës.

Gjatë dhe pas luftës në Kosovë, mbi 1 milion persona janë dëbuar nga vendi. Ku vetëm gjatë 9 javëve të para pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, nga Kosova janë larguar më dhunë mbi 860.000 shqiptarë për në shtetet fqinje: Shqipëri (444.600), Maqedoni të Veriut (344.500) dhe Mal të Zi (69.900)⁷. Ndërsa menjëherë pas përfundimit të luftës në qershor të vitit 1999, mbi 200.000 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve tjera pakicë u larguan nga Kosova.⁸

Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë kanë regjistruar të vrarët dhe të zhdukurit gjatë dhe pas luftës në Kosovë, respektivisht nga 1 janar 1998 deri në 31 dhjetor 2022. Më poshtë janë të prezentuara statistikatat me të dhënat preliminare të nxjerra nga Libër Kujtimi i Kosovës.


Gjithsej 13.535 persona janë vrarë dhe zhdukur me forcë në Kosovë gjatë viteve 1998-2000:



⁷UNHCR. The Kosovo Refugee Crisis, An independent evaluation of UNHCR's emergency preparedness and response. 2000, fq.6, e qasshme: <https://www.unhcr.org/3ba0bbeb4.pdf>


⁸UNHCR. Kosovo: One last chance. 1999, fq.7, e qasshme: <https://www.unhcr.org/3c6914bc5.pdf>

Të dhënat statistikore mbi viktimat në Kosovë




Civil Ushtria Çlirimtare e Kosovës Armata Popullore Jugosllave Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë KFOR FARK

SIPAS KOMUNAVE:



SIPAS VENDIT TË VDEKJES:



MEKANIZMAT E DREJTËSISË TRANZICIONALE

Viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura dhe pushteteve autoritare, kanë të drejtë të shohin autorët e krimeve duke u dënuar, të dinë të vërtetën, të marrin dëmshpërblime për krimet e kryera ndaj tyre dhe gjithashtu të njëjtëve duhet tu ofrohen garancione të mos përsëritjes.⁹ Andaj shtetet post-konfliktit dhe post-autoritare, përmes mekanizmave gjyqësor apo jo-gjyqësor duhet të garantojnë:

- Të drejtën për Drejtësi
- Të drejtën për të Ditur
- Të drejtën në Dëmshpërblime (Reparacione)
- Reforma Institucionale

E DREJTA PËR DREJTËSI

Gjykimi i personave përgjegjës për shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut është obligim shtetëror ndaj viktimave, andaj institucionet përkatëse duhet të ndër marrin hapa konkret për të siguruar drejtësi.

⁹Termi viktimë në këtë buletin përfshin të gjitha format e viktimizimit, si dëmet njerëzore (vdekje, lëndim trupor, torturë, humbje e familjarëve, etj) dhe dëmet materiale (shkatërrimi i pronës, humbja e vendit të punës, plaqkitja e gjërave me vlerë, etj).

Gjykimet penale kontribuojnë në kthimin e dinjitetit të viktimave si dhe në kthimin e besimit të shoqërisë në sundimin e së drejtës. Ndjekja dhe gjykimi i krimeve të luftës bëhet nga gjykatat e rregullta dhe nga tribunalet ad-hoc.

Me ndjekjen dhe gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë deri me tani kanë qenë kompetente këto institucione gjyqësore: Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, Gjykatat e Rregullta (në Kosovë, Serbi dhe Mal të Zi) si dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës & Zyra e Prokurorit të Specializuar me seli në Hagë.


TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË (TPNJ):

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë është themeluar në vitin 1993 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), si përgjigje ndaj mizorive të shumta që po ndodhnin në Kroaci dhe në Bosnjë & Hercegovinë.

Raportet, që përshkruanin krime të llahtarshme ku mijëra civilë janë vrarë dhe lënduar, torturuar dhe keqtrajtuar seksualisht në kamp-burgjet dhe qindra mijëra janë dëbuar prej vatrave të tyre, shkaktuan indinjatë anembanë botës dhe i shtynë Kombet e Bashkuara të vepronin në këtë aspekt. TPNJ është gjykata e parë për krime lufte e themeluar nga OKB-ja dhe tribunali i parë ndërkombëtar për krime lufte që nga Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios të luftës së dytë botërore. Para këtij tribunali u gjykuan kryesisht përgjegjësit e profililit me të lartë politik, ushtarak dhe policor për krimet e kryera në ish-Jugosllavi, duke përfshirë edhe luftën në Kosovë. TPNJ e përfundoi mandatin në dhjetor të vitit 2017.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 15 persona

Të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për krimet e luftës në Kosovë: 8 persona



Slobodan Millosheviq ka ndërruar jetë gjatë procesit gjyqësor dhe nuk kemi një aktgjykim të formës përfundimtare.

GJYKIMET PËR KRIMET E LUFTËS PARA GJYKATAVE NË SERBI:


Deri në vitin 2003 proceset gjyqësore për krimet e luftës janë zhvilluar në kuadër të gjykatave të qarkut. Që nga viti 2003, Gjykata e Lartë në Beograd është i vetmi institucion gjyqësor i cili i gjykon krimet e luftës të cilat kanë ndodhur në territoret e ish-Jugosllavisë.




GJYKIMET PËR KRIMET E LUFTËS PARA GJYKATAVE NË MAL TË ZI:

Pranë gjykatave të rregullta në Malin e Zi janë proceduar dy raste për krimet e luftës në Kosovë. Aktakuza e parë kundër tetë (8) të akuzuarve është ngritur në vitin 2008.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 9 persona



Të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm:



Për momentin pranë gjykatave të Malit të Zi nuk ka asnjë rast në procedurë për krimet e luftës në Kosovë.


GJYKIMI I KRIMEVE TË LUFTËS NGA GJYKATAT VENDORE NË KOSOVË

Përmes rezolutës 1244 të OKB-së, misioni i UNMIK-ut ka qenë përgjegjës për organizimin e sistemit gjyqësor në Kosovë dhe në periudhën 1999-2008 ekskluzivisht ka qenë përgjegjës për ndjekjen dhe gjykimin e krimeve që janë kryer gjatë luftës në Kosovë. Më shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, mandati i UNMIK-ut për gjykimin e krimeve të luftës në Kosovë i kaloi misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit - EULEX. Kështu gjatë periudhës 2009 – 2018 EULEX ka qenë përgjegjës për gjykimin e krimeve që janë kryer gjatë luftës në Kosovë. Që nga qershori i vitit 2014, EULEX gradualisht ka filluar që ti transferoj kompetencat ekzekutive tek gjyqësori vendor, ku përfundimisht në qershor të vitit 2018 mandati ekzekutiv i EULEX-it për gjykimin e krimeve të luftës ka përfunduar.


Në maj të vitit 2015 në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) është krijuar Departamenti për Krimet e Luftës.

Deri në vitin 2019 procedurat gjyqësore janë zhvilluar në gjykatat Themelore të Kosovës, me ndryshimet e ligjit për gjykatat është krijuar Departamenti Special në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, ku që nga themelimi i këtij departamenti të gjitha aktakuzat për krimet e luftës tani gjykohen në këtë departament.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë: 117 persona



Të dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për krimet e luftës në Kosovë: 45 persona



GJYKIMI I KRIMEVE TË LUFTËS NGA DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS & ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR:

Me 3 gusht 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka votuar për ndryshimet kushtetuese me ç'rast janë krijuar kushtet për krijimin e këtyre dhomave. Kompetencat e këtyre dhomave janë që të hetojnë dhe gjykojnë krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit të cilat kanë ndodhur në periudhën kohore 1998-2000 në Kosovë e që ndërliken me raportin e Dick Marty.¹⁰ Përveç kësaj kategorie të veprave penale, këto dhoma kanë kompetencë për hetimin dhe gjykimin e rasteve që lidhen me pengimin e administrimit të drejtësisë që mund të ndodhin në kohën reale. Kjo gjykatë është me seli në Hagë dhe ka mandat të përkohshëm.

Të akuzuar për krimet e luftës në Kosovë:

6

Shqiptarë

Deri në qershor të vitit 2022 nuk ka të dënuar meqë asnjë gjykim nuk ka përfunduar.

E DREJTA PËR TË DITUR

Shoqëritë dhe individët kanë të drejtë të dinë të vërtetën për shkeljet masive të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura ose gjatë pushteteve autoritare. Njohja e së vërtetës është e domosdoshme për të arritur shërimin personal dhe kolektiv. Një nga mekanizmat me të njohur në këtë aspekt janë Komisionet e së Vërtetës.

¹⁰Raporti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës: "Trajtimi çnjerëzor i njerëzve dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë", 07.01.2011, Dok. 12462, i qasshëm në: <https://www.scp-ks.org/en/documents/council-europe-parliamentary-assembly-report-inhuman-treatment-people-and-illicit>

ÇFARË JANË KOMISIONET E SË VËRTETËS?

Komisionet e së vërtetës janë mekanizma jo-gjyqësor të cilët kanë për synim gjetjen e së vërtetës përmes rrëfimit të viktimave nga njëra anë dhe përgjegjëseve nga ana tjetër. Këto komisione themelohen nga shtetet me një mandat të qartë sa i përket kohës dhe qëllimit dhe funksionojnë si të pavarura më qëllim të hetimit dhe të raportimit për periudha kyçe të shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën.

Komisionet e së vërtetës përmes rekomandimeve, adresojnë masat që duhet të ndërmerren nga shtetet për të riparuar dëmet e shkaktuara gjatë periudhave të kaluara autoritare apo konflikti. Të paktën 40 komisione zyrtare për të vërtetën janë themeluar në mbarë botën që nga viti 1974.

Një nga komisionet e tilla më të njohura deri me tani është Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit në Afrikën e Jugut i cili u themelua nga qeveria e re e Afrikës së Jugut në vitin 1995 si përgjigje ndaj periudhës së aparteidit me qëllim gjetjen e së vërtetës për shkeljet e të drejtave të njeriut që kishin ndodhur në atë periudhë dhe për të kontribuar në pajtimin e popullsisë. Ky komision publikoi në tërësi 7 vëllime të raportit të tij përfundimtar, 5 vëllime në vitin 1998 dhe 2 të tilla në vitin 2003.

Iniciativat në Kosovë:

KOMRA – RRJETI PËR PAJTIM: KOMRA është një iniciativë rajonale e shoqërisë civile e filluar në vitin 2006 e cila ka për synim themelimin e një komisioni rajonal për të vërtetën. Por si pasojë e mungesës së bashkëpunimit nga të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë, kjo iniciativë nuk është funksionalizuar ende. KOMRA synon të dokumentoj faktet mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga data 1 janar e vitit 1991 e deri në datën 31 dhjetor të vitit 2001.

KOMISIONI PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN NË KOSOVË: Në vitin 2017, ish-presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, nisi procesin për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë. Deri në vitin 2020 janë organizuar një varg konsultimesh me grupet e interesit, duke përfshirë akademinë, shoqërinë civile, përfaqësuesit e viktimave, të rinjtë dhe grupe të tjera shoqërore. Në kuadër të kësaj nisme është krijuar një grup parapergaditor i cili ka hartuar aktin normativ mbi rregullimin dhe funksionimin e këtij komisioni, por me largimin nga detyra të ish-Presidentit Thaçi procesi i themelimit të një mekanizmi të tillë është ngrirë.

Përveç komisioneve të së vërtetës rol të madh në gjetjen e së vërtetës luajnë edhe iniciativat e tjera shtetërore të hulumtimit dhe dokumentimit, iniciativat e shoqërisë civile, mediat dhe iniciativat e tjera të shoqërisë.

E DREJTA NË DËMSPËRBLIME/REPARACIONE:

Dëmshpërblimet mëtojnë të adresojnë dëmet e shkaktuara nga shkelja sistematike e të drejtave të njeriut nga organet shtetërore apo nga mungesa e ndërmarrjes së masave konkrete shtetërore për të parandaluar këto shkelje nga akterë të tjerë jo-shtetëror. Ato mund të marrin formë të kompensimeve për humbjet e përjetuara, të cilat ndihmojnë në tejkalimin e disa prej pasojave të abuzimit. Dëmshpërblimet kontribuojnë në njohjen e statusit të viktimave dhe gjithashtu i'u ofrojnë rehabilitim dhe jetë më të mirë.

Llojet e dëmshpërblimeve:

Sipas formës:

KOMPENSIMI: Kompensimi është forma më e shpeshtë e dëmshpërblimeve dhe i referohet pagesave monetare apo formave tjera materiale që duhet të ju bëhen viktimave në kompensim të shkeljeve të të drejtave të njeriut që u janë shkaktuar.

REHABILITIMI: Rehabilitimi nënkupton masat të cilat ofrojnë kujdes social, mjekësor dhe psikologjik për viktimat, përfshirë edhe shërbimet juridike.

KTHIMI NË GJENDJËN E MËPARSHME: Kthimi në gjendjen mëparshme i referohet atyre masave që synojnë rivendosjen e statusit të mëparshëm (quo ante) të viktimave. Këto masa mund të përfshijnë rivendosjen e të drejtave si shtetësia, liria deri tek kthimi i pronës, kthimi në punë e kështu më radhë.

SATISFAKSIONI/ KËNAQËSIA EMOCIONALE E VIKTIMAVE: Satisfaksioni është një formë dëmshpërblimi që një shtet mund të sigurojë për të korrigjuar një dëmtim të shkaktuar nga një veprim i padrejtë për të cilin është përgjegjës. Kjo formë e dëmshpërblimit mund të përfshijë: pranimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, shprehja e keqardhjes, kërkim faljet nga zyrtarët e autorizuar shtetëror e kështu me radhë.

Sipas mënyrës së ofrimit:

MATERIALE: Dëmshpërblimet materiale nënkuptojnë kompensimet në formë të pagesave në para ose përmes paketave të shërbimeve të cilat mund të përfshijnë mbështetje për arsimim, shëndet dhe strehim.

SIMBOLIKE: Dëmspërblimet simbolike iu referohen masave të përbashkëta jo materiale të cilat mund të përfshijnë letra formale të kërkim faljes nga udhëheqësit shtetëror, (ri)varrimi i viktimave, ditët kombëtare të përkujtimit, hapësira të dedikuara publike, si: parqe, muze, memoriale, etj.

Në bazë të ofruesit të dëmspërblimeve:

ADMINISTRATIVE: Dëmspërblimet simbolike iu referohen masave të përbashkëta jo materiale të cilat mund të përfshijnë letra formale të kërkim faljes nga udhëheqësit shtetëror, (ri)varrimi i viktimave, ditët kombëtare të përkujtimit, hapësira të dedikuara publike, si: parqe, muze, memoriale, etj.

DËMSHPËRBLIME TË PËRGJEGJËSISË: Ofrohen nga përgjegjësitet e shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura apo gjatë pushteteve autoritare. Të tilla mund të jenë: kompensimet e dëmit, kërkim faljet publike, puna në komunitet në të mirë të viktimave dhe forma të tjera.

REFORMAT INSTITUCIONALE

Reformat institucionale i referohen transformimit të institucioneve publike që i kanë kontribuar konfliktit apo i kanë shërbyer një regjimi autoritar. Procesi i reformimit institucional duhet të transferoj ato institucione në institucione efektive që garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut, ruajnë paqen dhe sigurojnë sundimin e ligjit. Reformat institucionale promovojnë përgjegjësinë dhe ndihmojnë në parandalimin e përsëritjes së dhunës.

Llojet e reformave institucionale:

ÇARMATIMI, DEMOBILIZIMI DHE RI-INTEGRIMI: Shpërbërja e aktorëve të ndryshëm të armatosur si p.sh. ushtrive guerile apo grupeve paramilitare – si dhe krijimi i kushteve të favorshme për integrimin e ish-luftëtarëve në familje dhe shoqëri.

TRANSFORMIMI I KORNIZAVE LIGJORE: Reformimi ose krijimi i kornizave të reja ligjore, të tilla si miratimi i amendamenteve kushtetuese apo i traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për të siguruar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

REFORMA STRUKTURORE: Ristrukturimi i institucioneve për të promovuar integritetin dhe legjitimitetin, duke siguruar llogaridhënie, ndërtimin e pavarësisë, duke siguruar përfaqësim gjithëpërfshirës, si dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

VERIFIKIMI (VETINGU): Verifikimi kontribuon në largimin nga institucionet publike e të gjithë atyre shërbyesve civilë të cilët i kanë shërbyer pushtetit represiv dhe kështu kanë kontribuar në shkëlqjen e të drejtave të njeriut apo kanë qenë pjesë e aparatit shtetëror gjatë konflikteve të armatosura dhe janë përgjegjës në mënyrë direkte apo tërthorazi për krimet e kryera gjatë konfliktit. Në këtë mënyrë, procesi i verifikimit mundëson që institucionet publike të jenë të përbëra nga shërbyes civilë që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët pa dallim dhe gjithashtu garanton mospërsëritjen.

MBIKËQYRJA: Krijimi i organeve mbikëqyrëse brenda institucioneve shtetërore për të siguruar përgjegjshmërinë në qeverisje civile.

EDUKIMI: Edukimi gjatë konflikteve të armatosura dhe veçanërisht gjatë pushteteve autoritare përdoret si një mjet propagande për të shtyrë përpara agjendat shtetërore dhe për të krijuar ndasi mes komuniteteve të ndryshme. Andaj, shtetet post-autoritare dhe post-konfliktit duhet të adaptojnë sistemin arsimor dhe kurrikulat edukative në mënyrë që të njëjtat të kontribuojnë në paqe të qëndrueshme. Gjithashtu është e rëndësishme që të ketë programe edukimi dhe trajnimi për zyrtarët shtetërorë lidhur me normat dhe standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.